



nr 9 prot date 12.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 6, datë 11.03.2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK”,
NËPËRMJET “HEC TROJET (NIVELI 1)” TË SHOQËRISË “TROIJET
ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik” nëpërmjet “HEC TROJET (NIVELI 1)”, të shoqërisë “TROIJET ENERGY” sh.p.k., me vendndodhje: në përroin e Kasajve dhe Trezhinievës, degë e Lumit Bushtricë, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

HEC “TROJET (NIVELI 1)”

Vepra e marrjes (KRGJSH):

Niveli i parë (Rezervuari ekzistues i Kasajve)

- $X = 515777$
- $Y = 4696307$
- $Z = 420 \text{ m.m.n.d}$
- $Q_{\text{mes-vjet}} = 0.5 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{\text{llog}} = 1.3 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{\text{eko}} = 0.008 \text{ m}^3/\text{s}$

Godina e Centralit (KRGJSH):

- $X = 514755$
- $Y = 4695048$
- $Z = 357 \text{ m.m.n.d}$

Pika e shkarkimit (KRGJSH):

- $X = 514739$
- $Y = 4695059$
- $Z = 355.25 \text{ m.m.n.d}$

Fuqia e instaluar $N = 700 \text{ kW}$
 Energjia Vjetore $E = 1'768'532 \text{ kWh/vit.}$

3. Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim hidroenergjetik jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

